



**Republika e Kosovës  
Komuna Malishevë**



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Malishevë shpall:

---

## **Konkurs**

### **Pranim**

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

---

|                          |                                         |
|--------------------------|-----------------------------------------|
| <b>Emri i grupit</b>     | Specialistë të Përgjithshëm të Mjedisit |
| <b>Institucioni</b>      | Komuna Malishevë                        |
| <b>Nr. i Referencës</b>  | RN00011925                              |
| <b>Kodi</b>              | RPC0005518                              |
| <b>Data e njoftimit</b>  | 21.06.2023                              |
| <b>Afati për aplikim</b> | 12.07.2023 - 19.07.2023                 |

---



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të

objektivave të njësisë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;

2. Në bashkëpunim me mbikëqyrësin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon

ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;

3. Analizon rregulloret, standardet dhe procedurat në fushën e planifikimit dhe zhvillimit dhe rekomandon përmirësimin

e proceseve nëse është e nevojshme;

4. Identifikon sfidat dhe çështjet e planifikimit urban, merr pjesë në zgjidhjen e tyre, siguron dhe zbatimin e legjisllacionit.

5. Analizon gjendjen në teren dhe në bazë të gjendjes reale i propozon sektorit të planifikimit dhe zhvillimit urban hapat

e mëtejme të zgjerimit të zonës urbane;

6. Merr pjesë aktive në planifikimin e komunës në të gjitha planet zhvillimore komunale dhe hartës zonale komunale si

dhe informon qytetarët me ndryshimet në plane;

7. Punon, përgatit dhe lëshon informim lidhur me Planet Zhvillimore Komunale, Hartën Zonale

Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme;

8. Është përgjegjës për mbajtjen e të gjitha planeve urbane teknike të aprovuar, dhe njofton vazhdimisht me zbatimin

dhe ndryshimet që ndodhin;

9. Koordinon punën dhe aktivitetet me sektorin e ndërtimit dhe inspektoratin komunale në mënyrë të shkëmbimit të

informatave me interes të dyanshëm;

10. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme

kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;



## 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve, fakulteti, **Inxhinieri Mjedisi/ Kimi e Përgjithshme, Ekologji**. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);
- Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase;
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1

## 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të plotë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të mira metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike dhe në marrjen e vendimeve;
- Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

## 5. Pozitat aktualisht të lira

---



| Kodi       | Nr. i Referencës | Titulli i pozitës               | Klasa e pozitës | Koeficienti | Institucioni     | Organizata / Vendi i punës                                | Nr. i kërkuar |
|------------|------------------|---------------------------------|-----------------|-------------|------------------|-----------------------------------------------------------|---------------|
| RPC0005309 | RN00011698       | Zyrtar për Planifikim Hapësinor | Profesional 2   | GJ36/4.95   | Komuna Malishevë | Drejtoria për Urbanizëm / Zyrtar për Planifikim Hapësinor | 1             |

## 6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- ? Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- ? Kopjet e dëshmisë së punësimit ( ose Trustin Pensional );
- ? Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- ? Kopjen e letërnjoftimit;
- ? Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime;
- ? Të gjithë kandidatët që kanë mbarruar studimet jashtë shtetit të Republikës së Kosovë si dhe nëpër Kolegjet Private brenda RKS-së, e që konkurojnë për këtë pozitë duhet që diploma e tyre (grada universitare të fituara) të jenë të njohura dhe të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

## 9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Të ketë njohuri në legjislacionin dhe politikat vendore dhe standardet në lëmin e ndërtimeve;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Auto Cad, QGIS, Archi Cad, Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).



## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

**VËREJTJE:** Koeficienti i përcaktuar për këtë konkurs do të jetë subjekt i harmonizimit konform ligjit të ri të pagave!

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen